



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura-III

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale

Mbledhja nr. 7

Prishtinë, më 01 prill 2008, ora 14:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

i mbledhjes së Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale

Në mbledhje morën pjesë: Sadik Idriz, Rita Hajzeraj, Flora Brovina, Nurishahe Hulaj, Teuta Hadri, Armend Zemaj, Gjylnaze Sylja, Qamile Morina.

Munguan: Slobodan Petroviq, Mimoza Ahmetaj dhe Bujar Bukoshi.

Të pranishëm:

Nga Zyra e Komisioneve të Kuvendit: Shpresa Haxhijaj dhe Fatime Qorri

Nga Zyra e Presidentit të Kosovës: Nexhat Shatri

Nga OSBE: Lejla Selimi

Nga NDI: Shefki Kastrati.

Mbledhjen e kryesoi z. **Sadik Idriz**, kryetar i Komisionit.

Komisioni zhvilloi punimet me këtë

REND DITE

1. Miratimi i rendit të ditës
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar
3. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për skemën e ndihmës sociale në Kosovë
4. Shqyrtimi i Projektligjit për rehabilitimin profesional dhe për punësimin e personave me aftësi të kufizuara
5. Shqyrtimi i Projektligjit për përkrahje materiale të familjeve të fëmijëve me aftësi të përhershme të kufizuara
6. Të ndryshme

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari konstatoi se rendi i ditës u miratua pa plotësime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar

Qamile Morina - Tha se në procesverbalin e mbledhjes së kaluar, në diskutimin e saj ku thuhet “ndryshimin e vlerës”, nuk ka thënë vetëm për vlerën që është prej kursimeve, por: “ndryshimi i vlerës dhe i ngritjes”, pasi është llogaritur edhe ngritja e pensioneve edhe ngritja e kursimeve.

Procesverbali i mbledhjes së kaluar u miratua me vërejtjen e cekur më lart.

3. Shqyrtimi i projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për skemën e ndihmës sociale në Kosovë

Kryetari - Tha se propozuesit e amendamenteve lidhur me këtë Projektligj janë takuar si grup pune dhe i kanë harmonizuar amendamentet. Ai e ftoi kryesuesen e grupit të punës, Nurishahe Hulaj, që t'i paraqesë këto propozime.

Nurishahe Hulaj - Pasi i falënderoi të pranishmit, tha se grupi i punës e ka bërë harmonizimin e propozimamendamenteve. Ajo i njoftoi anëtarët e Komisionit se deputetja Mimoza Ahmetaj është tërhequr prej propozimeve të saj, përveç një propozimamendamenti. Për grupin e punës ky Projektligj është përfunduar dhe mund të kalojë në seancë. Tha se disa nga propozimamendamentet kanë implikime të vogla buxhetore.

Kryetari – E falënderoi grupin e punës për punën e bërë dhe e hapi diskutimin për propozimamendamentet e paraqitura nga ky grup.

Gjynaze Sylja – E përgëzoi grupin e punës për punën e bërë. Tha se nuk ka vërejtje, por ka disa propozime për riformulimin e disa amendamenteve.

Nurishahe Hulaj - I propozoi amendamentet e harmonizuara para Komisionit.

Qamile Morina - Tha se ka vërejtje në propozimamendamentin 5. Këtu janë dy përkufizime: *jetimi* dhe *prindi vetushqyes*. Në qoftë se është jetim, atëherë është pa të dy prindërit, ndërsa përkufizimi për prindin vetushqyes, është në pikën tjetër. Pastaj tha se neni 2.7 i duket shumë problematik dhe konfuz sa i përket përmbajtjes. Nga përmbajtja e pikave **i**, **ii**, **iv**, **v** dhe **vi** krijohet përshtypja se është fjala për fëmijët deri në moshën 18-vjeçare, prandaj ajo mendon se këto pika mund të thjeshtësohen vetëm në një pikë, ku përfshihen fëmijët prej 1-18 vjeç.

Kryetari - Tha se sponsoruesit e këtij Projektligji në këto pika nuk kanë propozuar plotësime as ndryshime, domethënë kjo për ta nuk përbën problem për implementim.

Teuta Hadri - Tha se për mendimin e saj ky nen ka një kategorizim të mirë.

Armend Zemaj - Tha se person i varur, sipas këtij neni, është ai që i takon njërit prej këtyre grupeve.

Rita Hajzeraj - Tha se ligji është shumë më i kuptueshëm falë punës së grupit të punës.

Kryetari - Tha se nëse duhet të votojmë për propozimin e deputetes Qamile Morina, atëherë ajo duhet të na ofrojë një propozim konkret.

Qamile Morina - Tha se edhe në mbledhjen e kaluar e ka shtruar çështjen se në Projektligjin për përkrahje materiale të familjeve të fëmijëve me aftësi të përhershme të kufizuara nuk ka kategorizim të këtyre fëmijëve, mirëpo i ka thënë deputetja Mimoza Ahmetaj, se ky kategorizim është në Ligjin për skemën e ndihmës sociale. As në këtë Projektligj nuk ka kategorizim dhe propozoi që ky kategorizimi të hyjë në këtë Projektligj.

Gjylanze Sylja - Propozoi një formulim tjetër për amendamentin 9, “të drejtën për ndihmë sociale e fiton kërkuesi ose marrësi pasi t`i përmbledhë kërkesat financiare të përzgjedhshmërisë në pajtim me kushtet e përcaktuara me ligj. Kriteret do të përcaktohen me urdhëresë administrative që nxirret në afat prej një muaji”.

Kryetari – I ftoi anëtarët e Komisionit për të votuar lidhur me propozimamendamentet e grupit të punës me propozimin e deputetes Gjylanze Sylja për riformulimin e amendamentit 9.

Amandamenti 1

Në preambulë fjala “**nevojtarë**“ zëvendësohet me fjalën “**në nevojë**“

Komisioni funksional

Amendamenti 2

Në nenin 2, paragrafi 2, pika **ii** riformulohet:

Personi me aftësi të kufizuara që merr pension të aftësisë së kufizuar në bazë të skemës së ndihmës sociale nga Buxheti i konsoliduar i Kosovës.

Komisioni funksional

Amendamenti 3

Në nenin 2, paragrafi 2, pika **iii** riformulohet:

iii. Personi që paguhet me hyrjen në fuqi të Ligjit për statusin dhe të drejtat e familjeve të dëshmorëve, të invalidëve, të veteranëve e të pjesëtarëve të UÇK-ës dhe të familjeve të viktimave civile të luftës.

Komisioni funksional

Amendamenti 4

Në nenin 2, paragrafi, 2 pika **iv** riformulohet:

iv. Pagesat financiare që i marrin nga Buxheti i konsoliduar i Kosovës anëtarët e familjes me të drejtë për ndihmë sociale, do të llogariten si të hyra të llogaritshme dhe do të merren parasysh kur të përcaktohet madhësia e familjes që e përcakton shumën e ndihmës sociale.

Komisioni funksional

Amendamenti 5

Në nenin 2, pas paragrafit 2, shtohet një paragraf i ri:

Në nenin 2, paragrafi 5 riformulohet:

“Jetim” është fëmija deri në moshën 18-vjeçare, të cilit i ka vdekur njëri ose të dy prindërit, gjegjësisht nëse e ka vetëm njërin prind mbajtës të familjes (vetushqyes).

Komisioni funksional

Amendamenti 6

Në nenin 2, pas paragrafit 3, shtohet një paragraf i ri:

Në nenin 2, paragrafi 7 riformulohet:

Person me aftësi të kufizuara, që ka nevojë për asistencë të përhershme edhe për nevojat elementare jetësore, është:

i. Personi mbi moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeçare që ka aftësi të kufizuara për punë dhe ka nevojë për asistencë të përhershme për nevojat e veta elementare;

ii. Personat që janë gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeç ose më të moshuar;

iii. Kujdestarët e përhershëm të personave me aftësi përherë të kufizuara ose të personave të moshës gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeçare ose më të vjetër, të cilëve u nevojitet kujdes i përhershëm, ose fëmija nën moshën 5 vjeçe;

iv. Personat deri në moshën katërmëdhjetë (14) vjeçare;

v. Personat e moshave ndërmjet pesëmbëdhjetë (15) dhe tetëmbëdhjetë (18) vjeç dhe që janë në shkollim të rregullt të mesëm;

vi. Prindërit vetushqyes më së paku me një fëmijë nën moshën pesëmbëdhjetë (15) vjeçare.

Sipas këtij Ligji personat që i takojnë cilitdo grup të shënuar në nën-paragrafët

(i) deri në **(vi)** më lart, konsiderohen persona me aftësi të kufizuara për punë të shpërblyeshme, për shkak të aftësisë së kufizuar dhe nevojës për asistencë të përhershme për nevojat e veta personale elementare.

Komisioni funksional

Amendamenti 7

Në nenin 2, pas paragrafit 4 shtohet një paragraf i ri:

Në nenin 2, paragrafi 9 riformulohet:

Një person konsiderohet me aftësi të kufizuara nëse është i moshës mbi tetëmbëdhjetë (18) vjeç dhe nën moshën 65 vjeç dhe ka aftësi të kufizuara të përhershme në shkallë jo më pak se 80% për punë të shpërblyeshme në kohën prej paraqitjes së kërkesës deri në periudhën jo më pak se dy vjet.

Komisioni funksional

Amendamenti 8

Në nenin 3, paragrafi 1, pas emërimit: „Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale“, shtohen fjalët: „çdo 6 muaj“.

Komisioni funksional

Amendamenti 9

Në nenin 4, pas paragrafit 1 shtohet një paragraf i ri 2:

Në nenin 5, paragrafët 5.2, 5.4, 5.5 dhe 5.6 hiqen dhe riformulohen: Të drejtën për ndihmë sociale e fiton kërkuesi ose marrësi që i përmbush kërkesat financiare të përzgjedhshmërisë në pajtim me kushtet e përcaktuara ligjore. Kriteret do të përcaktohen me urdhëresë administrative që nxirret menjëherë në afat prej një muaji pasi të botohet ligji në Gazetën zyrtare.

Komisioni funksional

Amendamenti 10

Në nenin 4, paragrafi 1, në fund të paragrafit pas fjalës „funksionale“ shtohen fjalët: „sipas kriterëve të caktuara ligjore“.

Komisioni funksional

Amendamenti 11

Neni 4, paragrafi 2 hiqet.

Komisioni funksional

Amendamenti 12

Në neni 4, paragrafi 3 riformulohet:

Paragrafi 7 i neni 5 ndryshohet dhe riformulohet:

i. Të hyrat e llogaritshme përfshijnë: të hyrat e fituara dhe të pafituara, dërgesat e parave, pensionet bazë, pensionet e aftësisë së kufizuar, pagesat financiare që u janë dhënë anëtarëve të familjes sipas skemës së ndihmës sociale, kurse në të ardhmen sipas Ligjit për statusin dhe të drejtat e familjeve të dëshmorëve, të invalidëve, të veteranëve e pjesëtarëve të UÇK-ës dhe të familjeve të viktimeve civile të luftës. Ndërsa pensionet e sistemit të pensioneve individuale të kursimit dhe të pensioneve plotësuese individuale, të punëdhënësve, pensionet e fituara jashtë vendit, disa pagesa të përgjithshme dhe lloje të ndryshme të të hyrave, përcaktohen me akte nënligjore 3 muaj pas hyrjes në fuqi të këtij Ligji.

ii. Të hyrat e pallogaritshme përfshijnë: pagesat e njëhershme që u jepen familjeve që e fitojnë të drejtën për ndihmë sociale, siç përcaktohet në këtë Ligj; prodhimin shtëpiak për konsum familjar dhe ndihmat financiare dhe lloje të tjera të të hyrave, të përcaktuara me aktet nënligjore 3 muaj pas hyrjes në fuqi të këtij Ligji.

Komisioni funksional

Amendamenti 13

Pas nenit 4 shtohet nen i ri me këtë përmbajtje:

Neni 7, paragrafët 1 dhe 2 riformulohen:

Familja që ka fituar të drejtën e ndihmës sociale në përputhje me nenin 4, pika 1(a) dhe 1 (b), do të marrë ndihmë sociale deri një vit.

Qendra për punë sociale ose ndonjë organ gjegjë, i caktuar nga Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale, vazhdimisht i përcjell gjendjen, dëshmitë dhe në rast nevoje kërkon dëshmi të reja. Kjo rregullohet me urdhëresë të veçantë administrative një muaj pas hyrjes në fuqi të Ligjit.

Komisioni funksional

Amendamenti 14

Në nenin 5, paragrafi 1 do të jetë:

Në nenin 9, paragrafi 1 në fund të paragrafit, pas emërimit: „Mirëqenie Sociale”, të shtohen fjalët „çdo vit”.

Komisioni funksional

Amendamenti 15

Në nenin 6, pas fjalës „ligjore” të shtohen fjalët: „në afatin prej 8 ditësh,, dhe vazhdon teksti si në P/ligj.

Komisioni funksional

Amendamenti 16

Pas nenit 6 shtohet nen i ri me këtë përmbajtje:

Në nenin 12, paragrafi 12.1, pas fjalisë „Vetëm një anëtar i familjes mund të kërkojë ndihmë” shtohet shprehja: „, të veçantë në çdo kohë, për nevoja të jashtëzakonshme për vete ose për familjen”.

Komisioni funksional

Amendamenti 17

Në nenin 7, afati prej „ 6 muajsh “, të jetë „ tre muaj”

Komisioni funksional

Amendamenti 18

Neni 9 riformulohet:

Ky Ligj hyn në fuqi pas miratimit nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe menjëherë pas nënshkrimit nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

Komisioni FunkSIONAL

Kryetari konstatoi se unanimisht u miratuan amendamentet e propozuara në Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për skemën e ndihmës sociale në Kosovë.

4. Shqyrtimi i Projektligjit për rehabilitimin profesional dhe për punësimin e personave me aftësi të kufizuara.

Kryetari - Tha se për këtë Projektligj raportuese është znj. Flora Brovina që e ftoj të paraqesë se deri në cilën pikë ka arritur ky Projektligj.

Flora Brovina - Tha se ka pasur rastin të kontaktojë me disa përfaqësues të organizatës ILO-s, vërejtjet e tyre ishin se me këtë Ligj janë obliguar punëdhënësit që çdo të 25-tin punëtor ta kenë person me aftësi të kufizuara. Kjo është në kundërshtim me ligjet evropiane.

Komisioni në mandatin e kaluar ka pasur dëgjime me përfaqësuesit e personave me aftësi të kufizuara dhe me të gjitha asociacionet dhe organizatat që merren me persona me aftësi të kufizuara, por asnjëherë nuk janë dëgjuar përfaqësuesit e punëdhënësve. Ajo tha se ka kontaktuar me Odën Ekonomike dhe me personin që merret me mbrojtjen e punëdhënësve dhe se këta persona nuk janë të njohur me këtë Ligj, prandaj propozoi që Komisioni ta dëgjojë edhe mendimin e tyre, që Ligji të bëhet sa më i zbatueshëm.

Armend Zemaj - Tha se me këtë Projektligj janë paraparë lehtësi doganore për punëdhënësit që i punësojnë personat me aftësi të kufizuara. Konsideroj që kjo çështje duhet të shqyrtohet me kujdes, pasi punëdhënësit mund ta keqpërdorin këtë duke regjistruar persona me aftësi të kufizuara si të punësuar të tyre me qëllim që të përfitojnë nga këto lehtësi.

Gjylnaze Syla - Tha se është mirë të konsultohet Virtyt Ibrahimaga, meqë është njohës i ligjeve evropiane, në mënyrë që të shohim se si është e rregulluar kjo çështje me ligje evropiane. Kjo do ta ndihmonte Komisionin për formulim të saktë të amendamentit.

Kryetari - Tha se meqë i kemi disa pyetje që duhet sqaruar lidhur me pozitën e punëdhënësve, si dhe i kemi po ashtu propozimamendamentet e reja nga Flora Brovina, Teuta Hadri dhe Qamile Morina, atëherë le të jetë ky grup pune ai që do ta bëjë harmonizimin e propozimamendamenteve, të kontaktojë me përfaqësuesin e punëdhënësve dhe në mbledhjen e radhës Komisionit t'i paraqesë një propozim të përbashkët.

5. Shqyrtimi i Projektligjit për përkrahje materiale të familjeve të fëmijëve me aftësi të përhershme të kufizuara

Kryetari – Tha se edhe për këtë pikë të rendit të ditës do të takohet grupi i punës që t'i harmonizojë propozimamendamentet dhe në mbledhjen e radhës Komisionit t'ia paraqesë si propozim të përbashkët. Propozime mund të bëjnë edhe anëtarët e tjerë të Komisionit dhe t'i dërgojnë te raportuesi. Këtë grup pune e përbëjnë Flora Brovina, Teuta Hadri dhe Qamile Morina.

6. Të ndryshme

Kryetari - Lidhur me kërkesën e Drejtorit të Qendrës Emergjente tha se do të ftohet për t'u dëgjuar ndoshta mbas dy javësh, pastaj Komisioni do të vendosë se a do të dëgjohet më vonë edhe ministri i Shëndetësisë.

Armend Zemaj - Ishte i mendimit që të ftohet në mbledhje drejtori i Qendrës Klinike Universitare, sepse parashtruesi i kërkesës është vetëm drejtor i Qendrës Emergjente.

Gjylnaze Syla - Tha se kërkesa që e ka shtruar specialisti është shumë më e madhe se kërkesa e lëndës, meqë ai ka kërkuar strategji kombëtare dhe reformim në shëndetësi. Ajo ishte e mendimit se pikërisht ky Komision duhet ta dëgjojë drejtorin e Qendrës Emergjente, ta organizojë një dëgjim publik lidhur me këtë, si dhe të shkojë në vendngjarje për ta dhënë në seancë një propozim konkret. Ajo konsideron se kjo çështje nuk mund të zgjidhet vetëm me dëgjimin e drejtorit të QKUK-së.

Qamile Morina - Tha se në raportin e mandatit të kaluar që është bërë për zbatimin e Ligjit ka krijuar përshtypje se nuk është problem vënia e rekomandimeve, as bërja e një analize të tillë, por problemi esencial është se si mund të zbatohen ato rekomandime. Asaj i intereson si mund të obligohen ata që t'i zbatojnë rekomandimet e dala nga ky Komision.

Mbledhja e radhës do të mbahet të martën e ardhshme.
Kryetari e shpalli mbledhjen e mbyllur në orën 15:38

Përgatitur nga
Zyra e Komisioneve të Kuvendit

Kryetari i Komisionit,
Sadik Idriz